

fq. 2 Mbi publikimin e rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë
“Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të
Mbiqëqyrjes Financiare për vitin 2013”

VËSHTRIM MBI TREGJET

- » Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-maj 2014

fq. 2-3

ZHVILLIME TË TJERA

- » Bashkëpunime rajonale
- » Takim i përbashkët i grupit të punës të IOPS-it dhe OECD-së mbi pensionet private
- » Seminar për rregullatorët mbi Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
- » Seminar për mbikëqyrjen me bazë risku të sigurimit të rrezikut të katastrofave
- » Konferenca rajonale për mbrojtjen konsumatore dhe edukimin financiar
- » Seminar mbi problematikat lidhur me grupet në sigurime
- » Trajnim mbi pajtueshmërinë dhe inspektimin e tregut të kapitalit
- » Seminar mbi sfidat në kuadrin rregullator të letrave me vlerë dhe zgjidhjet praktike për kapërcimin e këtyre sfidave

*fq. 3-4**fq. 4-5**fq. 5-6**fq. 6**fq. 7**fq. 7-8**fq. 8-9**fq. 9*

LAJMET NGA RAJONI

- » Kroaci » Mali i Zi » Rumani

fq. 10-11

STUDIME DHE BOTIME

- » Treguesit Kryesorë Ekonomik, Volumi 2014, nr. 6 - Botim i OECD-së

fq. 11

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Mbi publikimin e rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2013”

Në datat 9.04.2014 dhe 16.04.2014 u paraqit Raporti dhe u zhvillua seanca dëgjimore pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat në Kuvendin e Shqipërisë, të Kryetares së AMF-së, Znj. Enkeleda Shehi, “Mbi veprimtarinë e institucionit gjatë vitit 2013”.

Pas këtyre veprimtarive, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2013”.

Për të lexuar tekstin e plotë të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, klikoni këtu.

<http://www.amf.gov.al/files/File/Kuvendi%20rezolute%20per%20AMF%202013.pdf>

Vështrim mbi tregjet

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-maj 2014

Tregu i sigurimeve u rrit me 29.71% gjatë periudhës janar-maj 2014. Vlera e primeve të shkruara bruto në këtë periudhë arriti rreth 4.4 miliardë lekë. Kjo u shoqërua me ulje të numrit të policave të sigurimit me 4.60% duke arritur në 364,360 polica.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, gjatë periudhës janar-maj 2014 regjistruan një ulje me 6.32% në krahasim me periudhën janar-maj 2013. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 0.88 miliardë lekë, apo 82.35% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

SIGURIMI I JO-JETËS

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 31.76% gjatë periudhës janar-maj 2014, krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

SIGURIMI I DETYRUESHËM MOTORIK

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 2.33 miliardë lekë gjatë periudhës janar-maj 2014, duke shënuar një rritje prej 62.44% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës janar-maj 2014 zuri 53.36% të tregut të sigurimeve.

KLASA TË TJERA NË SIGURIMIN E JO-JETËS

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:


- » Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë, të cilat zunë 18.26% të tregut të Jo-Jetës;
- » Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme, të cilat së bashku zunë 13.05% të tregut të Jo-Jetës.

SIGURIMI I JETËS

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 15.59% krahasuar me periudhën janar-maj të vitit 2013. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori” dhe përbën 51.64% të sigurimit të Jetës.

NDARJA E TREGUT TË SIGURIMEVE, JANAR-MAJ 2014

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



ZHVILLIME TË TJERA

Bashkëpunime rajonale

Zhvillohet takimi i shtatë rajonal i rregullatorëve të tregjeve të sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore

Autoriteti Austriak i Tregut Financiar (FMA) në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimeve të Maqedonisë (ISA) zhvilluan në datë 2 qershor, në Ohër, Maqedoni takimin rajonal të rregullatorëve të tregjeve të sigurimeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore. Ky ishte takimi i shtatë në kuadër të iniciativës së vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore, CESEE, për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet mbikëqyrësve të sigurimeve të këtyre vendeve.

Diskutimet kryesore në takim u përqendruan në forcimin e bashkëpunimit midis mbikëqyrësve dhe kolegjeve të përbashkëta të mbikëqyrjes. Gjithashtu u diskutua lidhur me sfidat kryesore me të cilat përballen rregullatorët e tregjeve të sigurimit në procesin e zbatimit të kërkesave lidhur me strukturat qeverisëse të grupeve, rolin e mbikëqyrësve në procesin e hartimit të kontratave të sigurimit dhe zbatimin e kërkesave rregullatore lidhur me to.

Aktuarja e AMF-së, Marsela Vaska, bëri një prezantim lidhur me zbatimin e tarifimit me bazë risku në produktet e sigurimit të detyrueshëm MTPL, i cili çoi në një diskutim të frytshëm në drejtim të shkëmbimit të eksperiencave të rregullatorëve. Personalitete të larta të organizmave ndërkombëtarë trajtuan çështje të ndryshme mbi mundësitë dhe sfidat me të cilat përballen tregu i sigurimeve në përgjithësi, si dhe aspekte të rëndësishme që lidhen me mbikëqyrjen e tij.

Konferenca aktuariale për rregullatorët e tregjeve të sigurimeve

Agjencia e Sigurimeve të Maqedonisë (ISA), zhvilloi në datë 3 qershor në Ohër, Maqedoni konferencën aktuariale për rregullatorët e tregjeve të sigurimeve. Në konferencë u trajtuan çështje me interes të veçantë për vendet në zhvillim, në prezantimet me fokus në rolin e aktuarëve dhe qeverisjes së korporatave; marrëdhëniet me Bordin e Drejtorëve të kompanisë, detyrimet dhe kundërvajtjet e përcaktuara ligjrisht, apo shtylla II e regjimit Solvency II.

Në prezantime u vu theksi në edukimin e vazhdueshëm aktuarial si një nga drejtimet kryesore të cilësisë aktuariale. Në këtë kuadër u theksua, praktika e licencimit, roli i shoqatave profesionale dhe trajtimi i të gjitha problemeve tipike të një komuniteti të ri aktuarial. Ndikimi i punës aktuariale tek mbikëqyrja e tregut të sigurimit, u trajtua si partneritet mes rregullatorëve dhe aktuarëve, si dhe angazhimit të audituesve në auditimin e pavarur.

Kjo konferencë shërbeu si një platformë për shkëmbimin e përvojave dhe nxitjen e mëtejshme të profesionit të aktuarit në vendet pjesëmarrëse të iniciativës CEESSE.

Takim i përbashkët i grupit të punës të IOPS-it dhe OECD-së mbi pensionet private

Organizata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Pensioneve (*International Organisation of Pensions Supervisors, IOPS*) në bashkëpunim me dhe Organizatën për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (*Organisation for Economic Cooperation and Development, OECD*), zhvilluan në datat 3-4 qershor, Paris, Francë takimin e përbashkët të grupit të punës mbi pensionet private.

Takimi synonte shkëmbimin e përvojave më të mira për zhvillimin e reformave në sistemin e pensioneve, përmirësimin e kuadrit ligjor, si dhe ndërtimin e strukturave efikase dhe kapaciteteve teknike si një kusht për krijimin e sistemeve të shëndetshme të pensioneve private.

Temat kryesore që u trajtuan në seminar ishin:

- » Rishikimi i principeve bazë të rregullimit dhe mbikëqyrjes së pensioneve private;
- » Projekti mbi produktet e pensioneve dhe garancitë e tyre;
- » Vdekshmëria dhe risku i jetëgjatësisë, ku u diskutua mbi uljen e normave të interesit si rrjedhojë e rritjes së jetëgjatësisë. Për stabilizimin e saj janë përdorur kontribute shtesë në rritjen e pensioneve;
- » Projekti mbi mjaftushmërinë e kursimeve për daljen në pension;
- » Strategjitë e investimeve të pensioneve sipas kërkesave të metodologjisë së mbikëqyrjes me bazë risku. Përdorimi i metodologjisë me bazë risku në pensione përcakton strategjitë për investime;
- » Tregjet e kapitalit dhe instrumentet për transferimin e riskut të jetëgjatësisë, etj

Komiteti Ekzekutiv (EC) i IOPS-it diskutoi mbi zhvillimet më të fundit dhe çështjet administrative të organizatës. Në mbledhjen e Komitetit Teknik (TC) u paraqit draft-udhëzuesi i përgatitur nga grupet e punës mbi praktikën më të mira për qeverisjen e autoriteteve mbikëqyrëse të pensioneve, si dhe mbi kërkimet e informacionet e mbledhura nga organizma të tjerë ndërkombëtare si Banka Botërore (BB) dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) që bashkëpunojnë me IOPS-in në fushën e pensioneve.

Në paraqitjen që bëri përfaqësuesi i BB vuri theksin në katër elementet bazë që ndikojnë në sistemin e pensioneve: mjedisin ekonomik dhe politik; kuadrin e përgjithshëm, shtyllat e tjera dhe rregullat kryesore; strukturën e tregut, subjektet dhe qeverisjen; si dhe mbikëqyrjen. Një temë tjetër e trajtuar nga përfaqësuesi i IOPS-it, ishte roli i aktuarit dhe përllogaritjet në mbikëqyrjen e pensioneve. Në prezantim u përshkrua rëndësia e aktivitetit të aktuarit, funksionet e tij, mënyrat e përllogaritjes në skemat e pensioneve, si dhe bashkëpunimi ndërmjet ekspertëve aktuarë dhe mbikëqyrësve të pensioneve. Në takime u vu theksi në nevojën e përmirësimit të komunikimit mbi pensionet, në vështirësitë e të kuptuarit të skemave të pensioneve, ndërgjegjësimi mbi pensionet, që është në përgjithësi i ulët, dhe risqet për pensionet që janë në rritje. Nga eksperiencia e IOPS-it u arrit në përfundimin se mënyra më e mirë për të trajtuar këto çështje është informimi objektiv, hartimi i politikave dhe mbikëqyrja.

Seminar për rregullatorët mbi Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

Qendra e Bankës Botërore për Reformën në Raportimin Financiar dhe Fondacioni i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (*International Financial Reporting Standards, IFRS*) organizuan në datat 4-6 qershor në Vjenë, Austri, seminarin e dytë ekzekutiv mbi IFRS-të, me pjesëmarrjen e mbikëqyrësve nga Evropa dhe Azia Qendrore.

Qëllimi i seminarit ishte njohja me IFRS-të aktuale, diferencat që karakterizojnë këto standarde me kërkesat rregullatore, duke vënë në dispozicion mjetet për të rritur efektivitetin e rregullimit të tregjeve.

Temat kryesore që u trajtuan në seminar ishin:

- » Përditësimi i ndryshimeve të fundit të IFRS-ve dhe projekteve në vijim të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (*International Accounting Standards Board, IASB*), duke përfshirë IFRS 9, 10, 11 dhe 12, si dhe projektin për të zëvendësuar IFRS 4 me një standard më gjithëpërfshirës në lidhje me kontabilizimin dhe raportimin e kontratave të sigurimeve;
- » Çështje të ndryshme mbi gjykimin dhe vlerësimet në aplikimin e IFRS-ve me fokus kryesor në testin për zhvlerësim të investimeve financiare dhe mbrojtëse (*hedging*);
- » Kuptimi i diferencave midis raportimit financiar dhe kërkesave të kujdesshme të rregullatorëve.

Temat e mësipërme u prezantuan nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare.

Seminar për mbikëqyrjen me bazë risku të sigurimit të katastrofave

Shoqëria e risigurimit Europa Re, në bashkëpunim me Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë, zhvilluan në datë 9 qershor, në Shkup, Maqedoni seminarin për mbikëqyrjen me bazë risku të sigurimit ndaj katastrofave.

Gjatë seminarit u prezantua:

- » Draft-rregullorja për mbikëqyrjen me bazë risku për sigurimin e katastrofave (tërmete), e cila kishte si objekt vendosjen e parimeve bazë të mbikëqyrjes me bazë risku të sigurimit nga tërmetet. Rregullorja mundëson vendosjen e një baze ligjore të domosdoshme dhe të përshtatshme për sigurimin e rrezikut të humbjes së pronës nga tërmetet, por edhe për mbikëqyrjen efektive të tij;
- » Modeli i riskut dhe harta e rrezikut për sigurimin nga tërmetet, rezultati i modelimit të riskut në lidhje me humbjen maksimale të mundshme (*probable maximum loss, PMLs*) për çdo shtet, mbështetur në prezantimin e CATRADER (*software për llogaritjen e PMLs*).

Qëllimi i seminarit ishte, jo vetëm ofrimi i njohurive të reja për mbikëqyrjen me bazë risku të katastrofave/tërmete, por ai shërbeu edhe si një platformë për shkëmbimin e përvojës dhe ndarjes së informacionit midis pjesëmarrësve.

Konferenca rajonale për mbrojtjen konsumatore dhe edukimin financiar

Komisioni i Mbikëqyrjes Financiare të Bullgarisë në bashkëpunim me Bankën Botërore zhvilluan në datat 10-11 qershor 2014, në Sofje, Bullgari, konferencën rajonale për mbrojtjen konsumatore dhe edukimin financiar. Përfaqësuesit e institucioneve rregullatore, pjesëmarrëse në konferencë, i kushtuan rëndësi trajtimit të çështjeve të ndryshme lidhur me mbrojtjen dhe edukimin financiar të konsumatorit.

Çështjet kryesore që u diskutuan gjatë konferencës ishin:

- » Kërkesat për mbrojtjen e konsumatorit dhe veprimtaritë mbikëqyrëse të autoriteteve të mbikëqyrjes financiare;
- » Teknologjia dhe ndikimi i saj në mbrojtjen e konsumatorit, gjetja e një ekuilibri mes rregullimit dhe inovacionit;
- » Ndryshimi i qëndrimeve të të rinjve ndaj financave personale dhe aftësisë financiare;
- » Rritja dhe forcimi i aftësive financiare të popullsisë - përvoja të ndryshme ndërkombëtare.

Në konferencë kishte prezantime edhe nga ekspertë të Bankës Botërore që paraqitën përvojat më të suksesshme dhe mundësitë e rritjes së mbrojtjes dhe edukimit të konsumatorit.

Seminar mbi problematikat lidhur me grupet në sigurime

Instituti për Stabilitet Financiar organizoi në datat 11-13 qershor, në Bazel, Zvicër seminarin mbi problematikat lidhur me grupet në sigurime. Synimi i seminarit ishte rritja e njohurive të rregullatorëve dhe mbikëqyrësve në sigurime për problematikat dhe pikat delikate me të cilat ndeshet mbikëqyrja e grupeve që veprojnë në tregun e sigurimeve kudo në botë.

Temat kryesore të trajtuara në seminar ishin:

- » Tre nivelet e mbikëqyrjes së grupeve;
- » Mbikëqyrja e grupeve dhe kolegjet mbikëqyrëse;
- » Siguruesit me rëndësi globale e sistemike;
- » Mbikëqyrja e konsoliduar e grupeve sistemike të rëndësishme në sigurime;
- » Mbikëqyrja e konglomerateve financiare dhe e çështjeve të tjera ndërsektoriale;
- » Zgjidhjet dhe rregullimet për siguruesit ndërkufitarë që kanë rëndësi sistemike.

Trajnerë në këtë seminar ishin ekspertë në fushën e sigurimeve dhe të legjislacionit ndërkombëtar. Gjithashtu prezantuan në këtë seminar edhe ekspertë nga organizmat ndërkombëtare financiare si Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS), Banka Ndërkombëtare e Rregullimeve (BIS, Bank for International Settlements) si edhe ekspertë të autoriteteve rregullatore nga Zvicra, Litenshteini, Holanda dhe Britania e Madhe.

Në ditën e parë ju kushtua më shumë rëndësi përcaktimit të bërë edhe nga IAIS për kërkesat e arkitekturës ndërkombëtare të mbikëqyrjes dhe rolit që secili nga nivelet ka si më poshtë:

Niveli 1: Parimet Bazë në Sigurime (ICP) sipas IAIS;

Niveli 2: Kuadri i Përbashkët (ComFrame) për mbikëqyrjen e grupeve aktive ndërkombëtare në sigurime;

Niveli 3: Masat rregullatore të grupeve sistematike të rëndësishme në sigurime (G-SIIs).

Arkitektura e IAIS për nivelet e mbikëqyrjes

Lloji i entitetit	Entitete Juridike	Grup	Grupet Aktive Ndërkombëtare në Sigurime (IAIG)	Siguruesit me rëndësi sistematike ndërkombëtare (G-SII)
Kërkesat e mbikëqyrjes dhe veprimet				
Niveli i parë: ICPs	ICPs të zbatueshme vetëm për entitetet juridike	ICPs të zbatueshme vetëm për entitetet juridike dhe grupet		
Niveli i dytë: ComFrame	ComFrame			
Niveli i tretë: paketa për G-SII				Paketa e masave për G-SII

Gjatë ditës së dytë, seminari kishte të kombinuar prezantimet teorike me eksperiencat praktike të vendeve të ndryshme. Gjithashtu u punua në grupe për të evidentuar efektin e ndryshimeve në tregun e sigurimeve kur influencohet edhe vetëm një nga shoqëritë vepruese në tregun e sigurimeve të një vendi.

Një rëndësi e veçantë ju kushtua edhe aksesit në informacion dhe shkëmbimit të informacionit midis rregullatorëve të vendeve të ndryshme të grupeve të sigurimeve. U theksua se bashkëpunimi me informacione të sakta dhe në kohën e duhur nga rregullatorët është i rëndësishëm, sidomos lidhur me grupet në sigurime.

Trajnim mbi pajtueshmërinë dhe inspektimin e tregut të kapitalit

Në datat 23-27 qershor 2014 në Washington DC, u organizua një program trajnimi mbi pajtueshmërinë dhe inspektimin e tregut të kapitalit. Në këtë trajnim morën pjesë përfaqësues nga më shumë se 25 vende të ndryshme të botës. Ai shërbeu si një forum dinamik për shkëmbimin e praktikave më të mira në zhvillimin dhe rregullimin e tregut të letrave me vlerë, të prezantuara këto nëpërmjet leksioneve, tavolinave të rumbullakta dhe studimit të rasteve të ndryshme.

Nëpërmjet këtij programi ju dha mundësi përfaqësuesve të vendeve me tregje në zhvillim të ndajnë eksperiencat e tyre dhe të diskutojnë për problemet kryesore të tregut të titujve, duke theksuar gjithashtu praktikatat më të mira ndërkombëtare në një përpjekje për të zhvilluar sisteme të fuqishme rregullatore, të cilat rrisin mbikëqyrjen dhe funksionimin sa më të mirë të tregjeve të letrave me vlerë në mbarë botën.

Gjatë këtij trajnimi u diskutuan tema të ndryshme si: mbikëqyrja dhe inspektimi me bazë risku, ndërtimi efektiv i një programi inspektimi, standardet dhe pajtueshmëria e mbikëqyrjes, tregtimi me frekuencë të lartë, cilësia e tregut dhe hyrja në treg, inspektimi dhe mbikëqyrja e brokerit të titujve, konflikti i interesit, inspektimi i këshilltarit në investime, pastrimi i parave, mashtrimi dhe abuzimi nga këshilltarët e fondeve të investimeve, si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar dhe shkëmbimi i informacionit.

Temat e mbuluara gjatë seminarit u fokusuan në teknikat e balancuara, të provuara dhe pragmatike për mbikëqyrjen dhe inspektimin e subjekteve të tregut të letrave me vlerë në kryerjen e hetimeve dhe marrjen e masave efektive për zbatimin e tyre.

Sesionet e ndryshme kishin si qëllim t'i ofronin përfaqësuesve një kuptim më të madh të këtyre temave sipas këndvështrimit të lektorëve, të cilët kishin përvojë në sektorin privat dhe publik, duke përfshirë dhe demonstrimin e ekspertizës së tyre në fushat përkatëse.

Seminar mbi sfidat në kuadrin rregullator të letrave me vlerë dhe zgjidhjet praktike për kapërcimin e këtyre sfidave

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Letrave me Vlerë (*IOSCO*) në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare Federale të Gjermanisë (*BaFin*) zhvilluan në datat 26-27 qershor në Frankfurt, Gjermani, seminarin mbi sfidat në kuadrin rregullator të letrave me vlerë dhe zgjidhjet praktike për kapërcimin e këtyre sfidave.

Programi i seminarit përfshinte çështjet lidhur me sfidat e reja me të cilat përballen sot rregullatorët e letrave me vlerë, si dhe rrugët për kalimin e këtyre sfidave. Programi u hap me një paraqitje nga sekretariati *IOSCO*-s mbi zhvillimet e fundit në organizatë.

Temat e diskutimit ishin:

- » Sfidat teknologjike për çështje të mbikëqyrjes efektive të tregut dhe mjetet rregullatore;
- » Mënyrat më të mira për trajtimin e sfidave rregullatore;
- » Kontrolli me bazë riskun;
- » Edukimi dhe mbrojtja e investitorëve;
- » Produktet e reja, si dhe problemet e tyre;
- » Roli i auditit në qeverisjen e korporatave dhe etika;
- » Parimet e aplikueshme të *IOSCO*-s, rregullat, standardet ndërkombëtare dhe rekomandimet, etj.

Mjaft diskutime u përqendruan në mënyrat e zhvillimit të një hetimi kompleks, si dhe hapat konkretë për zhvillimin e tij. Prezantimi i përfaqësuesit të *BaFin* mbi manipulimet në treg dhe kryerjen e hetimit për parandalimin e tyre ishte me mjaft interes për pjesëmarrësit.



LAJMET NGA RAJONI

KROACI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave paraprake të publikuara nga Byroja e Sigurimeve Kroate, në tre muajt e parë të vitit 2014, tregu i sigurimeve arriti në 2.45 miliardë HRK (monedha kroate afërsisht 320 milionë euro) ose 2.7% më e pak se në tremujorin e parë të vitit 2013.

Sigurimi i Jo-Jetës gjatë tremujorit të parë 2014 regjistroi një rënie prej 5.9% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur në vlerë 1.79 miliardë HRK (afërsisht 233 milionë euro), ndërsa sigurimi i Jetës arriti 661 milionë HRK, me një rritje 7% krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2013.

MALI I ZI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave paraprake të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve, tregu i sigurimeve të Malit të Zi arriti afro 15.6 milionë euro në fund të marsit të vitit 2014. Kjo vlerë e tregut të sigurimeve pasqyron një rënie prej 2.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Për të njëjtën periudhë, vlera e dëmeve të paguara nga shoqëritë lokale të sigurimit arriti në 7.1 milionë euro.

Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i takon sigurimit të Jo-Jetës me afërsisht 83% të volumit total. Në sigurimin e Jo-Jetës pjesa më e madhe i përkiste sigurimit TPL e brendshme.

Volumi i primeve të shkruara bruto në tregun rumun të sigurimeve ka rënë me 3.43% në tre muajt e parë të vitit 2014, duke arritur në 466 milionë euro. Sigurimi i Jo-Jetës arriti në 380 milionë euro prime, ose 2.09% më pak se në tre muajt e parë të vitit 2013, ndërsa sigurimi i Jetës është ulur edhe më shumë, me rreth 9% duke arritur në 87 milionë euro.

Presidenti i FSA-së, Rumani Z. Misu Negritoiu deklaroi për XPRIMM "...Tregu i sigurimeve ka qenë relativisht i qëndrueshëm në fillim të vitit, edhe pse ka ende probleme strukturore të trashëguara nga vitet e mëparshme. Ne mund të shohim disa përmirësime, veçanërisht si rezultat i ndërhyrjes së Autoritetit Rumun të Mbikëqyrjes Financiare. Ne jemi tani duke u përqendruar në zgjidhjen e çështjeve individuale dhe vendosjen e tregut në një bazë solide".

Ndërsa primet ranë, dëmet e paguara u rritën lehtë, me gati 1%, në një total prej 298 milionë euro, nga të cilat 121.5 milionë euro ishin për shkak të segmentit të TPL-së së brendshme.

STUDIME DHE BOTIME

Treguesit Kryesorë Ekonomik, Volumi 2014, nr. 6 - Botim i OECD-së

Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (*Organisation for Economic Co-operation and Development, OECD*) ka publikuar këtë muaj botimin "Treguesit Kryesorë Ekonomik". (*Main Economic Indicators MEI*). Ky botim përmes analizave krahasuese statistikore mujore jep një vështrim të përgjithshëm të zhvillimeve më të fundit ekonomike ndërkombëtare për 34 vende të OECD-së, të cilat i përkasin eurozonës, si dhe një numri vendesh jo anëtare të eurozonës.

http://www.oecd-ilibrary.org/economics/main-economic-indicators/volume-2014/issue-6_mei-v2014-6-en

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin